



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Grand Construction shpk" të datës 24.05.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "141 Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve" me nr. të prokurimit 616-25-3717-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si pjesërisht bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Grand Construction shpk" të datës 24.05.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "141 Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve" me nr. të prokurimit 616-25-3717-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Grand Construction shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 24.05.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "141 Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve" me nr. të prokurimit 616-25-3717-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi ankimore 1:

Juve si Autoritet Kontraktues – Komuna Prishtine, për këtë procedure te prokurimit ne dosje te tenderit gjegjesisht ne FDT, tek kerkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, keni aplikuar kerkesa kunderilgjore dhe te cilat nuk kane kurrefare lidhje me natyren e aktivitetit te prokurimit dhe objektin e kontratës.

Ne pozicionin 3, te pikës 9.1 & 9.2 te FDT-se keni kerkuar:

Operatori Ekonomik duhet te angazhoje punetore te trajnuar me aftesi profesionale si ne vijim:

- A) shtate (7) punetor, duhet te dorezohen marreveshje mbi angazhimin e tyre
- B) Një (1) person te trajnuar dhe certifikuar si njeshter saldini
- C) Një punetore te certifikuar për saldinin e gypave PVC PE
- D) Një punetore te certifikuar për testimin e gypave sipas standardit EN 805 W 400

Ndërsa si dëshmi dokumentare keni kerkuar:

Te deshmohet me kopje te diplomes, kontrate te punes me punedhenesin ose marreveshje për këtë projekt.

Kjo kerkese kualifikuese, qone ne lidhje te kontratës me kompani te caktuara, shkele parimet bazike te prokurimit publik dhe si e tille mund te ketë pasoje edhe financiare edhe juridike për autoritetin kontraktues, sepse ne paramase dhe paralogari, perkatesish pozicionet e saja nuk parashifet saldini i gypave, testimi i gypave, si rrjedhoje kerkesa e lartecur për staf te tille është ne kundërshtim me dispozitat ligjore dhe është përcaktuar vetëm për te favorizuar

kompani te caktuara. Madje me piken a) keni kerkuar marreveshje mbi angazhimin e stafit dhe jo staf te kompanise, kjo qarte le për te kuptuar sekemi te bëjmë me kurdise te procedurës, perderisa ne deslumine dokumentare keni kerkuar si dëshmi Diplomen, kontraten e punes apo marreveshjen për projekt.

Kerkesa dhe deshmia dokumentare janë ne shperputhje me njera tjetren dhe si te tilla ne vlerësim eventual te ofertave mund te interpretohen ne favor te kompanive te caktuara perkatësish ne dem te kompanive tjera.

Pretendimi ankimore 2

Ngjashëm është vepruar edhe ne pozicionet 5 dhe 6 te kerkeseve te kapacitetit teknik dhe profesional ku keni kerkuar:

5. Autorizimi dhe katalogu per pozicionet 3.0, 8.0, 14.0, 15.0, 23.0, 24.0, 25.0, 42.0, 43.0, 44.0, 45.0, 46.0, 47.0, 55.0, 56.0, 57.0,

6. Garancioni per pozicionet 3.0, 8.0, 14.0, 15.0, 23.0, 24.0, 25.0, 42.0, 43.0, 44.0, 45.0, 46.0, 47.0, 55.0, 56.0, 57.0, minimum 2 vite.

Për te gjitha pozicionet ne te cilat është kerkuar autorizim i prodhuesit, është përcaktuar emri i prodhuesit te gypave "Pipelife", si rrjedhoje aplikimi i tille paraqet shkelje te nenit 28.7, te LPP-se ku percaktohet:

"Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhim. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6, të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent"

Pavarësisht faktit se ju si AK –Komuna Prishtine ne paramase dhe paralogari për këto pozicione gjegjesisht produkte keni pershkruar emrin e prodhuesit ose te ngjashme, veprimi i tille bie ndesh me dispozitat ligjore dhe shkele parimet e prokurimit publik, si rrjedhoje te

gjitha këto pozicione duhet të korrigojnë dhe të largohet kërkesa për "Autorizim" të prodhuesit për këto produkte, pasi që me kërkesë të tilla kontrata lidhet vetëm me kompani të caktuara.

Me nenin 70, të LPP-se – standardet për sigurimin e cilësisë, kjo përcaktohet që:

"Po që se autoriteti kontraktues kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, autoriteti kontraktues do t'u referohet sistemeve për sigurimin e cilësisë që: (i) bazohen në standardet përkatëse Kosovare, Evropiane ose ndërkombëtare dhe (ii) të certifikuara nga organet që kryejnë veprimtaritë e tyre në pajtim me ato standarde për ushtrimin e aktiviteteve të tyre të certifikimit lidhur me aktivitetet e certifikimit. Autoriteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së. Autoriteti kontraktues po ashtu pranon të dhënat e tjera të besueshme për masat e barasvlershme të sigurimit të cilësisë nga operatorët ekonomik që nuk kanë qasje ose mundësi për sigurimin e certifikatave të tilla brenda afateve të caktuara".

Ndaj produkteve për të cilat juve si AK, keni kërkuar Autorizim të prodhuesit "Pipelife", mund të aplikohen masa tjera të sigurisë së cilësisë së përcaktuar me LPP-se, siç janë standardet Kosovare, Evropiane përkatësisht produkte të cilat pranohen nga një shtet anëtar i BE-se ashtu siç përcaktohet me LPP.

Aplikimi i tilla qon në lidhje të kontratës me kompani të para caktuara, cenon të drejtën e ofertimit të kompanive të kualifikuara dhe të cilat posedojnë kapacitete teknike dhe profesionale dhe mund të këtë pasoje financiare për AK dhe taksapaguesit, prandaj kërkesat e tilla do duhej të modifikoheshin dhe të largohet autorizimi i prodhuesit, përkatësisht përshkrimi i prodhuesit.

Pretendimi ankimore 3.

Përveç përcaktimit të prodhuesit në shumë pozicione të paramasës dhe parallogarise janë përcaktuar vlera fikse siç është pozicioni 14.0 "Pompe zhytese 3 fazore të tipit 4N7-23, 3.0kw dhe pozicionin 15, është aplikuar kapaciteti fiks i pompës zhytese, prej 3.0kw.

Aplikimi i kapacitetit me vlerë fikse perseri bie ndesh me dispozitat ligjore dhe parimet bazike të prokurimit publik

Me nenin 19, të Rregullores me nr. 001/2022, për prokurim Publik – Specifikimet teknike të detyrueshme, par 3, përcaktohet që:

"Specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, performanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimet dhe etiketimi. AK do të tregojë nëse specifikimet teknike të specifikuara janë obligative apo kërkesa minimale. Përdorimi i standardeve mund të përfshijë standarde të sigurimit të cilësisë siç është cekur në Nenin 70 të LPP-se".

Po ashtu neni 25.17 dhe 18, i RrPP-se, përcakton që:

*"Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.
" Gjate përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do t'i kushtojë rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formulojë kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rrishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të njefueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike..."*

Kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftim për kontratë, të përcaktuara në pikën 9.1 dhe 9.2 që kanë të bëjnë me kapacitetin teknik dhe profesional, në përgjithësi janë të kundërligjshme dhe shkelin parimet e prokurimit publik.

Këto kërkesa dhe dëshmi paraqesin shkelje të nenit 27, të LPP-se, lidhur me nenin 17.12 të Rregullores nr. 001/2022, për Prokurim Publik, ku përcaktohet:

- "Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kritere, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjalë në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është material themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderet e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata shtesë..."

Aplikimi i kërkesave diskriminuese, përkatësisht favorizuese paraqet shkelje të rënde të ligjit për prokurim publik e përcaktuar me nenin 97, të Rregullores nr. 001/2022, për prokurim publik pika d) dhe pikat tjera, prandaj për pozicionet 14.0, 15.0 dhe jo vetëm kërkojmë që të krijohet toleranca minimumi e kapacitetit të produktit apo të përcaktohet pragu dhe tavan i kapacitetit.

Pretendimi ankimor 4.

Në aneksin I – specifikimet teknike të dosjes së tenderit, përkatësisht në "përshkrimin teknik" të projektit juve si AK, keni publikuar projekt të sistemit të ujitjes Pipelife dhe nuk keni mundësuar ekuivalencë tjetër ashtu siç përcaktohet me dispozita ligjore në fuqi.

Prove: linku i prodhuesit: <https://www.pipelife.com>

Juve si AK mund te aplikoni standarde ndaj produktit, perkatësisht materialeve dhe nuk mund te kërkohej produkte te prodhuesve te caktuar, si rrjedhoje pershkrimi teknik për këtë projekt bie ndesh me rregullat ligjore te prokurimit publik dhe akteve tjera nenligjore.

Sherbime testuese laboratorike për punen dhe materialin te cilin vet OE e realizoj dhe furnizin ne vend punishte ne emer te projektit, prandaj keto kërkesa dhe certifikime sa i përket laboratorit te akredituar për testim te materialeve pajeter duhet te largohen nga dosja e tenderit.

Pretendimi ankimor 5.

Ne pozicionet tjera te paramases dhe parallogarise nga pozicionet 42, 43, 44, 45, e tutje keni përcaktuar perseri produkt te prodhuesit "Rainbird", për pajisjet e elektrovalvolave, ku juve si AK edhe ndaj ketuyre pozicioneve keni kërkuar Autorizim te prodhuesit, si rrjedhoje kërkesat e tilla, me paramase te tilla qon ne eliminim te teresishem te konkurrences dhe shkele rende paramet e prokurimit publik.

Prove: linku i prodhuesit "Rain Bird": <https://www.rainbird.com>

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se pretendimet janë pjesërisht të bazuara dhe në bashkëpunim me njësinë kërkuese duhet të rivlerësohet nëse kërkesat e DT janë të domosdoshme për të realizuar projektin në mënyrë efikase dhe efektive.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatorëve ekonomik".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.06.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.